



Prishtinë, 29 mars 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_935\_2018

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 16 paragrafi 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V\_757\_2016 të datës 28 janar 2016 për shoqërinë "Hydro - Line" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës; dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V\_757\_2016 të datës 28 janar 2016, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, të datës 26.01.2018 të shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K., me adresë "Mbretëresha Teutë", p.n. -Mitrovicë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V\_757\_2016 i datës 28 janar 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **28 janar 2019 për ndërtimin e Hidrocentralit.**

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 03.05.2013 nga ndërmarrja "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 9.85 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës.



- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria "Hydro Line" SH.P.K., ka vendosur se ky aplikacion ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_537\_2013 me datë 28 qershor 2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 26.05.2015 nga shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit V\_537\_2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, Hidrocentrali HC Albaniku 2 Lokacioni "Batahir" ZK "Batahir", komuna e Mitrovicës, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës dhe dëshmimeve relevante me datë 15.06.2015 ka aprovuar kërkesën me Vendimin V\_735\_2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_537\_2013 dt. 28 qershor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE me datë 09.10.2015 nga shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizimin Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 28 janar 2016 pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit, ka vendosur që shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K., ti lëshohet Autorizim Final V\_757\_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës.
- ZRRE me datë 26.01.2018 nga shoqëria "Hydro Line" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_757\_2016 të datës 28 janar 2016, për HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, **për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019.**
- Shoqëria "Hydro Line" SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim, dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: pas pranimit të vendimit për lëshimin e autorizimit nga Bordi i ZRRE-së, kenë filluar me përgatitjet teknike për të filluar me hapjen e rrugës dhe trases nëpër të cilën do të vendoset tubacioni duke filluar nga vepra e marrjes e deri te ndërtesa e Hidrocentralit HC Albaniku II., janë bërë në mënyrë të vazhdueshme matjet e nevojshme gjeodezike nga ekspertët e fushës, është përgatitur bazamenti i vendosjes së



veprës së marrjes dhe janë bërë të gjitha matjet e ndërtesës së hidrocentralit dhe vendosjes së turbinave sipas specifikave teknike të kërkuara nga ana e prodhuesit të turbinave.

- Shoqëria "Hydro Line" sh.p.k., në kërkesën e saj ka theksuar se edhe përkundër vështirësive është në fazën intezive të punimeve të finalizimit të trases bartjes së tubacionit dhe përgatitjes së ndërtesës së centralit.
- Gjithashtu përkundër vullnetit në realizimin e Hidrocentralit të dytë, për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme brenda afatit ligjor të caktuar nga ana juaj, është detyruar që ti drejtohet Bordit të ZRRE-së, për mundësinë e shtyrjes së vlefshmërisë së autorizimit për HC Albaniku II, edhe për një vit për mundësinë e finalizimit të projektit.
- Shoqëria Hydro Line SH.P.K., deri më tani ka finalizuar projektin e parë HC Albaniku I, me kapacitet të instaluar prej 4.27 MW, ZK Selac, i Autorizuar nga Bordi i ZRRE-së, sipas Vendimit V\_569\_2013 të datës 24 tetor 2013, dhe i cili projekt është finalizuar brenda afati ligjor të përcaktuar nga ZRRE-ja, edhe përkundër faktit që gjatë punimeve janë dalur shumë vështirësi në hapjen e rrugës dhe hapjen e kanalit dhe ndërtimit të veprës së marrjes e cila ka qenë e para që është realizuar në Kosovë, dhe që nga data 12 prill 2016 ka filluar prodhimin komercial dhe ka lidhur fillimisht marrëveshjen për blerje të energjisë me KESCO, si furnizues publik i obliguar për blerje të energjisë nga Burimet e ripërtritshme të ndërtuara sipas procedurës së autorizimit të ZRRE-së. Poashtu sipas kërkesave ligjore tani veç kanë bërë bartjen e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë nga KESCO në KOSTT sipas dispozitave ligjore të nenit 21 par 2 të Rregullës për Skemën Mbështetëse të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së. Vlen të theksohet me këtë rast se në atë projekt janë investuar më shumë se 6 milion euro, dhe të gjitha investimet janë investime private të realizuara nga ana e kompanisë tonë.
- Gjithashtu ka sqaruar se, shoqëria në fjalë është duke i realizuar edhe projektet HC Albaniku I. me kapacitet të instaluar prej 1.86 MW, i autorizuar me Vendimin V\_889\_2017 të datës 27 shkurt 2017 dhe projektin HC Albaniku IV. me kapacitet të instaluar 1.19 MW, i autorizuar me vendimin V\_890\_2017 të datës 27 shkurt 2017, ku shpresojnë se në bazë të dinamikës së punimeve dhe kushteve atmosferike të mund të i realizojmë të gjitha këto projekte brenda afateve ligjore, dhe njëkohësisht të sigurojmë prodhim të energjisë nga këto hidrocentrale s'bashku me projektet e HC Albaniku III. të finalizuar dhe HC Albaniku II. i cili është në fazën e ndërtimit e për të cilin jemi të obliguar të kërkojmë shtyrje të afatit të autorizimit për të finalizuar.
- Poashtu ka theksuar se edhe përkundër vështirësive në teren kanë bërë një progres të dukshëm në realizimin e punimeve në ndërtimin e këtij hidrocentrali, ku janë kryer shumë punë fizike ndërtimore, janë hapur komplet traseja për vendosjen e tubacionit nga vepra e marrjes deri te ndërtesa e hidrocentralit, e ku vonesat më të mëdha janë shkaktuar për shkak se kompania austriake për prodhimin e turbinave ka qenë shumë e ngarkuar me punë dhe si rrjedhojë nuk ka mundur të na furnizojë me pajisje elektromekanike të centralit. Pra nga rrethanat e krijuara ka ardhë deri te vonesat që na janë dalë gjatë realizimit të projektit sa më të saktë dhe brenda këtij afati.
- Arsyeja e kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit për Hidrocentralin HC Albaniku II, është se edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme nga ana jonë në përfundimin e realizimit të këtij projekti HC Albaniku II i autorizuar me vendim nga ana e ZRRE-së, nuk u arrit të realizohet brenda afatit të parë të caktuar me vendimin përkatës, për shkak të pengesave të cilat i paraqitëm më lartë, duke përfshirë vështirësitë teknike në teren, gjithashtu një fakt të




rëndësishëm e ka pasur edhe sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e këtij projekti dhe projekteve tjera që është duke i realizuar kompania jonë, duke marrë parasysh gjithashtu edhe faktin se këto projekte janë projekte të sistemit me kaskad, është dashtë të veprohet me kujdes të madh dhe të eliminohen të gjitha pengesat teknike, të cilat i kemi hasur gjatë realizimit të projektit HC Albaniku III, e i cili tani më i finalizuar dhe në prodhim komercial.

- Gjithashtu vlen të theksohet edhe njëherë se në vazhden e realizimit të këtij projekti për të cilën shpresojmë ta përfundojmë brenda këtij afati të kërkuar nga ana jonë, sipas dinamikës së punimeve priten të finalizohen edhe projektet e HC Albaniku I dhe HC Albaniku IV. Të gjitha këto kanë ndikuar në ngadalësimin e realizimit të punimeve si dhe paraqitjes së kërkesës për shtyrjen e afatit ligjor të vlefshmërisë së autorizimit edhe për një vit.
  - Andaj, duke pasur parasysh të gjitha ato që i paraqitëm më lartë, kërkojnë nga Bordi e ZRRE-së, që bazuar në dispozitat ligjore të nenit 16 paragrafi 4 të Rregullës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në fuqi në datën e lëshimit të Autorizimit V\_757\_2016, të datës 28 janar 2016, për ndërtimin e hidrocentralit HC Albaniku II. me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, si projekt i rëndësishëm për prodhimin e energjisë nga Burime e Rinovueshme, të aprovohet kërkesa për lejimin e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së Autorizimit për ndërtimin e hidrocentralit HC Albaniku II. **edhe për një vit**, pasi që mos-përfundimi i realizimit të këtij projekti ka ardhur nga faktorët e ndryshëm teknik, nga mos mundësia e furnizimit me pajisjeve elektronergjetike nga kompania austriake e kontraktuar për prodhimin e turbinave, dhe brenda këtij afati do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për të finalizuar projektin në fjalë brenda afateve ligjore të lejueshme.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës të shoqërisë “Hydro Line” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin “Batahir”, ZK Batahir, komuna e Mitrovicës, ka vlerësuar ato dhe ka konsideruar se për shkak të arsyeshmërisë së bazuar dhe të kompleksitetit të ndërtimit të Hidrocentraleve, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V\_757\_2016 i datës 28 janar 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim V\_757\_2016 i datës 28 janar 2016, do të vlen deri me datë **28 janar 2019**, pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_


Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
\_\_\_\_\_

Besim Sejfiqaj, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Selman Hoti, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së